

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Naim Mehulli**, me procesmbajtësen Fetije Pireva në çështjen juridike të paditësit: **B.P** nga të cilën sipas autorizimi me shkrim e përfaqëson Av.RK nga kundër të paditurit: **J.H** nga, tani me vendbanim te panjohur te cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av.B.M, baza e kontestit: kompensim demi, pas mbajtjes së seancës kryesore me datën: 08.10.2015 në prezencë të autorizuarve të palve ndrgjyegjse, me datën: 18.10.2015 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **OBLIGOHET**, i padituri që brenda afatit 15 ditor nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën prej 883 euro ne emër te kompenzimit të demit material,
- **OBLIGOHET**, i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditësit shumën prej 422.40 euro dhe atë: për padi 101.40 euro, për dy seanca të përfaqësuar nga avokati shumën prej 270 euro, 41 euro taksën për padi, 10 euro për shpallje ne gazet zyrtare, si dhe gjykatës 15 euro taksë për përpilimin e aktgjykimit të gjitha këto në afat 15 ditor nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja me datë: 18.02.2004 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit për kompenzimin e kompensim demi material.

I autorizuari i paditësit në seancë kryesore dhe ne fjalë perfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, me pretnedimin se me provat e administruara me pamedyshje u vërtetua kërkesëpadia-demi i shkatuar.

Meqenëse të paditurit nuk ju dihej vendbanimi, dhe pas kërkimit të adresave të të njëjtëtit nga organet kompetente gjykata ju caktoi përfaqësuesin e përkohshëm Av. B.M.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit ne seancën e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi: Padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses e kundërshtoj, mirëpo provat te cilat gjenden ne shkresat e lëndës nuk i kundërshtoi, ndërsa ia le gjykatës që në bazë të provave të vendos. Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: Vërtetimi i Stacionit Policor ne Jug nga njësia e hetimeve ne Mitrovicë te

datës 11.02.2004, procesverbali i përpiluar nga ana e paditësit pas vërshimeve ne librarin “....”.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Se demi material është shkaktuar ne librarin “....” ne kohe dhe vendin e cekur vërtetohet nga Vërtetimi i Stacionit Policor ne Jug nga njësia e hetimeve ne Mitrovicë te datës me te cilën është konstatuar se ne lokaln e paditësit B.P me datën 23.10.2003 është shkaktuar demi si pasoj e vërshimeve, dhe rasti është regjistruar ne Polici si “Dëmtim kriminal me nr.2003-BC-1841.

Sa i përket dëmtimeve nga procesverbali i bere menjëherë pas vërshimeve konstatohet se janë dëmtuar një numër i konsiderueshëm i librave vlera minimale e te cilëve arrin 883 euro.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar konform dispozitave të neneve: 185 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vjetri i aplikuar në këtë rast).

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazua në nenin 452 paragrafi i të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t’ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.79/2004 datë: 18.10.2015

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat 15 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.